



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 117/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.04.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **FIDANI L SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i stadionit të qytetit-faza II” Lot I-Ndërtimi i stadionit të qytetit- Tribuna Lindore dhe Lot II-Ndërtimi i stadionit të qytetit- Tribuna Jugore dhe fusha e stadionit,, me Nr. të Prok: 632-23-630-5-1-1, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **FIDANI L SHPK**, e datës 26.04.2023, lidhur me aktivitetin e “Ndërtimi i stadionit të qytetit-faza II” Lot I-Ndërtimi i stadionit të qytetit- Tribuna Lindore dhe Lot II-Ndërtimi i stadionit të qytetit- Tribuna Jugore dhe fusha e stadionit, me Nr. të Prok: 632-23-630-5-1-1, kundër **NJOFTIM PËR KONTRATË**, të publikuar nga Autoriteti Kontraktues, me datë 05.04.2023, në platformën elektronike të KRPP.
2. Autoriteti Kontraktues do të bëjë korrigjimin në dosje të tenderit dhe do të publikojë Formulari standard për korrigjimin e gabimeve (B54) në platformën elektronike të KRPP.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

## Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik **FIDANI L SHPK**, me dt.26.04.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i stadionit të qytetit-faza II” Lot I- Ndërtimi i stadionit të qytetit- Tribuna Lindore dhe Lot II-Ndërtimi i stadionit të qytetit- Tribuna Jugore dhe fusha e stadionit, me Nr. të Prok: 632-23-630-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-006-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i bazuar dhe Autoriteti Kontraktues vendos që të bëjë korrigjimin në dosje të tenderit dhe do të publikojë Formulari standard për korrigjimin e gabimeve (B54) në platformën elektronike të KRPP.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i Vendimit në platformën elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>**

Faton Gutaj  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës